



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 445/3 prot.

Elbasan, më 25.4.2024

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr. 36 datë 29.03.2024 “Për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullosor publik” dhe pasi u njohëm me të dhënat plotësuese të dërguara në institucionin tonë nga Kryetari Bashkisë Librazhd me shkresën e tij me Nr. 1948prot, datë 19.04.2024, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.
Akti juaj të zbatohet duke respektuar të gjitha procedurat ligjore në fuqi që kanë lidhje dhe vepronë në këtë fushë të veprimtarisë.

PREFEKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK



Nr. 1626/7 prot

VENDIM

Datë.03.04.2024

Nr.36 dt.29.03.2024

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ,Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Per pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike,sipas listës së inventarit,dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”. VKM nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”, VKM nr. 1374, datë 10.10.2008,të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen,shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor”, VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullësor publik”. pasi dëgjoi relacionin e Drejtorisë së Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, Keshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 29.03.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

V E N D O S I :

- 1.Të miratojë me shkrim vazhdimin e procedurave të mëtejshme të dhënies në përdorim të fondit pyjor e kullësor publik për ushtrimin e veprimtarive për parqe fotovoltaike për pjesë të ngastrës nr. 20a, 21a, 31a të Ekonomisë Pyjore Kuturman me sipërfaqe totale 13.2 ha.
2. Proçedurat e mëtejshme ligjore do të ndiqen nga Sekretari i Pergjithshem, Sektori Juridik, Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave Bashkisë Librazhd, Drejtoria e Urbanistikës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas miratimit.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT
Silvana HOXHA





8.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
DREJTORIA E MENAXHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

RELACION MBI PROJEKT-VENDIMIN

“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR E KULLOSOR PUBLIK”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 57/2020 datë 30.04.2020 “Për pyjet”, VKM nr.433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive i ndryshuar”.

VKM Nr. 888 datë 27.12.2022 “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve”.

VKM nr. 1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullor”.

Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.01 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”.

VKM Nr. 559, datë 29.7.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore” i ndryshuar,

Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pasi kreu studimin e të gjitha ngastrave të fondit pyjor që do jepen në përdorim, për qëllime parqe fotovoltaike, për pjesë të ngastrave nr. 20a, 21a, 31a të Ekonomisë Pyjore Kuturman me sipërfaqe totale 13.2 ha, i propozojmë Këshillit Bashkiak miratimin e këtyre pjesëve të ngastrave pyjore.

Ky qëllim është i orientuar në politikat e qeverisë Shqiptare për rritjen e kapacitetit të fuqisë prodhuese të energjisë elektrike nga energjia e rinovueshme e cila do ndikojë në rritjen e të ardhurave për bashkinë Librazhd dhe investime në fondin pyjor e kullor.

Veprimtaria e parashikuar në këto sipërfaqe nuk e dëmtojnë ekosistemin e zonës ku do të instalohen këto parqe fotovoltaike. Nisur nga arsyet e mësipërme ne propozojmë për dhënie në përdorim të sipërfaqeve që bëjnë pjesë në fondin pyjor/kullor të bashkisë Librazhd për parqe fotovoltaike me qëllim prodhimin e energjisë ku veprimtaria e mësipërme do të ketë një ndikim pozitiv në të ardhmen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetin rrethues, rritjen e vlerave ekonomike në zone dhe krijimin e vendeve të reja pune.

Theksojmë që këto sipërfaqe janë të formës së përdorimit shkurre, kullotë dhe shkëmbore. Në këto sipërfaqe nuk ka studime dhe plane zhvillimi për këto territore si dhe investime të tjera afatgjatë.

Për sa më sipër i kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin për fillimin e procedurave për dhënien në përdorim të këtyre sipërfaqeve të fondit pyjor të Bashkisë Librazhd në mënyrë që Drejtoria e Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave të vazhdojë procedurat e mëtejshme.

Jemi në pritje të miratimit nga ana J'uaj.


Përgjegjësi i Menaxhimit

Ing.Bledar ÇOTA



DREJTORI

Aleksandër BRAZHDA



PLANIMETRIA E SIPERFAQJES SE DHENE NE PERDORIM
EKONOMIA PYJORE KUTURMAN
SIPERFAQJA :13.2 ha

15300

435600

435900

436200

436500

